



Pranuar / Dorezuar Prijmjen / Prodato Received / Delivery	22-09-2023	3	viti god veq.
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SPAMSHCK	6200/2023		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1033/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi -anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, duke vepruar sipas ankesës me numër A.nr.1033/2023 të datës 27.07.2023 të parashtruar nga ankuesja [redacted] përmes përfaqësuesit me autorizim avokat [redacted] në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 22.09.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër me numër A.nr.1033/2023 e datës 27.07.2023 e parashtruar nga ankuesja [redacted]

A r s y e t i m

Ankuesja [redacted] e punësuar sipas Kontratës së punës të datës 19.08.2014 në pozitën e punës "Zyrtar i Rexhistrat Qendror", në sektorin e Arkivës pranë Policisë së Kosovës, më datën 26.04.2023 ka parashtruar kërkesë pranë organit të punësimit, respektivisht Policisë së Kosovës përmes të cilës ka kërkuar kompensimin material për shkak të kryerjes së punës shtese që rezultoi si shkak i rritjes së volumit të punës ku të njëjtën kërkesë e ka përsëritur edhe me datë 12.07.2023. Ndërsa me datën 17.07.2023 organi i punësimit respektivisht udhëheqës i drejtpërdrejt i ankueses i është përgjigjur ankueses duke i refuzuar kërkesën lidhur me realizimin e kompensimit material, me arsyetimin se dy zyrtarë janë caktuar për mbështetje dhe lehtësimin e punëve tuaj mirëpo ankuesja ka refuzuar që të angazhohen zyrtarët për ndihem pasi që nuk ka nevojë.

Ankuesja e pa kënaqur me përgjigjen e datës 17.07.2023 të organit të punësimit lidhur me refuzimin e kompensimit material, me datën 27.07.2023 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 5383/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me pretendim ankimore se në njësinë për administrim in e dokumenteve respektivisht në pozitën e ankueses janë vetëm dy zyrtare ku njëra është në pushim mjekësore dhe se ankuesja që nga muaji nëntor i vitit 2022 është duke e kryer e vetme punën, dhe se duke u bazuar në Rregulloren (QRK) Nr.08/2023 "Për shtesat për të punësuarit në Sektorin Publik" nën 8 dhe 9 parashihet pagesa shtese prej 20% e pagës bazë për pagesat e punëtorëve që punojnë në pune shtese për shkak të mungesës së punëtorëve.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 02.08.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në në Policinë e Kosovës . Ndërsa Këshilli, me datë 15.09.2023 përmes e-mailit ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Me Vendimin me numër të protokollit 5731/2023 të datës 04.09.2023, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka vazhduar afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.1033/2023 të datës 27.07.2023 edhe dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 5383/2023 të datës 27.07.2023 të parashtruar nga ankuesja përmes përfaqësuesit me autorizim në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 26.07.2023; Emalin e datës 05.07.2023 të S.Sallahu drejtuar H.Sopi; Emailin e datës 03.07.2023 të M.Berisha drejtuar S.Sallahu; Emailin e datës 26.06.2023 të S.Sallahu drejtuar M.Berisha; Emailin e datës 13.06.2023 të [redacted] drejtuar S.Sallahu; Emailin e datës 12.06.2023 të F. Abazi drejtuar [redacted] Emalin e datës 12.07.2023 të [redacted] drejtuar F.Abazi; emalin e datës 26.04.2023 të [redacted] drejtuar F.Abazi; Emailin e datës 12.06.2023 të S.Sallahu drejtuar F.Abazi; Emailin e datës 12.06.2023 të [redacted] drejtuar S.Sallahu; Emailin e datës 12.06.2023 të F.Abazi; Emailin e datës 12.06.2023 të [redacted] drejtuar F.Abazi; Emailin e datës 26.04.2023 të [redacted] drejtuar F.Abazi; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 02.08.2023; Përgjigjen në ankesë të datës 15.09.2023; Kontratën e punës të datës 22.05.2014; Vendimin e datës 04.12.2019; Përshkrimin e detyrave të punës të datës 01.06.2015; Emalin e datës 18.07.2023 të S. Sallahu drejtuar [redacted] Emalin e datës 18.07.2023 të [redacted] drejtuar S. Sallahu; Emalin e datës 10.07.2023 të [redacted] drejtuar S. Sallahu; Vendimin me numër të protokollit 5931/2023 të datës 04.09.2023 të Kryetarit të Këshillat të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkëngjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pabazuar sepse

Nga provat e administruara të lëndës rrjedhë së ankuesja është e punësuar sipas Kontratës së Punës të datës 20.11.2014 në pozitën e punës "Zyrtar i Regjistrimit Qendror", në sektorin e Arkivës pranë Policisë së Kosovës, e cila sipas anekses së datës 27.07.2023 të parashtruar në Këshillin e

Pavarur Mbikëqyrës kërkon që sipas Rregullores (QRK) Nr.08/2023 për shtesat për të punësuarit në sektorin publik, kompensimin e pagës shtese prej 20% të pagës baze për pagesën e punëtorëve që punojnë në punë shtesë për shkak të mungesës së punëtorëve.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të shkresave kryesore që lidhen me pretendimin e ankuesit analizoi dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik që ka hy në fuqi me 05.02.2023, i cili ligj në nenin 2 paragrafi 1 në lidhje me fushëveprimin parasheh: "1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj", ndërsa në nenin 22 paragrafin 1 të këtij ligji parashihen shtesat që mund përfitohen nga zyrtaret publikë:" 1.Shtesat që mund përfitohen në bazë të këtij ligji janë : 1.1. shtesa e veçantë për të zgjedhurat/it; 1.2. shtesa për kushte tregu të punës; 1.3. shtesa e performancës; 1.4. shtesa për kushte specifike të punës; 1.5. shtesa për punën pa orar të paracaktuar; 1.6. shtesa për vëllimin e punës; 1.7. shtesa për licencë të avancuar për nëpunësen/in e arsimit para universitar; 1.8. shtesa për nëpunësen/in e sistemit shëndetësor; 1.9. shtesa e performancës për krijuesen/in dhe performuesen/in e artit dhe kulturës; 1.10. shtesa funksionale. Ndërsa me nenin 28 është rregulluar mënyra e përfitimit të shtesës për vëllimin e punës ku parashihet se: "1. Organizatat buxhetore, në rastet e parashikuara nga ky ligj, mund të japin shtesën për vëllim të punës, për kryerjen e punës për shkak të rritjes së vëllimit të punës, nëse kanë mjete në dispozicion për këtë qëllim nga kursimet e fondeve të pagave që krijohen për shkak të mungesës së nëpunësve/ve civil, apo pozitive të paplotësuara për të cilat janë paraparë mjete në planin financiar të shfrytëzuesit buxhetor dhe fonde për projekte të veçanta. 2. Nëpunëset/it civil përfitojnë shtesën për shkak të rritjes së vëllimit të punës, për punën e kryer dhe që tejkalon rezultatet e pritshme të punës në një (1) muaj, nëse në këtë mënyrë është e mundur të sigurohet një mënyrë më racionale arritja e rezultateve të punës si dhe buxheti. 3. Shtesa për vëllimin e punës miratohet nga zyrtarja/i kryesor administrativ i institucionit, pas marrëveshjes me nëpunësen/in civil për të punuar me vëllim të shtuar. 4. Shtesa e përcaktuar në paragrafin 1. të këtij neni, nuk mund të jetë më e lartë se 0.5% e fondeve totale të përdorura nga organizata buxhetore, për pagën bazë të zyrtareve/ëve publik të organizatës buxhetore në të njëjtin vit financiar. 5. Për qëllim të zbatimit të këtij neni, Qeveria e Republikës së Kosovës do të trajtohet si një (1) organizatë buxhetore. 6. Rregullat për fitimin, vlerën e shtesës si dhe periudhën e përfitimit përcaktohen me akt nënligjor të Qeverisë, me propozim të ministrisë përgjegjëse për financa dhe me pëlqim të ministrisë përgjegjëse për administratën publike. 7...."

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në lidhje me objektin e kësaj ankese ka konstatuar se Qeveria e Republikës së Kosovës më datë 06.02.2023 ka nxjerrë Rregulloren (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik ku në nenin 1 të kësaj rregullore është përcaktuar qëllimi i saj ku theksohet "1. Kjo Rregullore ka për qëllim të përcaktojë kriteret, kushtet, rregullat, mënyrën e llogaritjes dhe procedurën për përfitimin e shtesave të mëposhtme për të punësuarit në sektorin publik:" 1.2. shtesa për vëllimin e punës.....,etj", ndërsa në nenin 9 të kësaj rregullore janë përcaktuar kriteret dhe procedura për përfitimin e shtesës për vëllimin e punës si: 1. Shtesa për vëllimin e punës mund të përfitohet nëse në këtë mënyrë është e mundur të sigurohet në mënyrë më racionale arritja e rezultateve të punës, si dhe buxheti. 2. Udhëheqësi i Njësisë dhe/apo Zyrtari Kryesor Administrativ mund t'i kërkojë një apo më shumë nëpunësve civil që të angazhohen me vëllim të shtuar të punës për një periudhë të caktuar kohore që nuk e tejkalon një (1) vit.

3. Periudha kohore e përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni mund të vazhdohet me marrëveshje të re dhe pëlqimin e të dyja palëve. 4. Në asnjë rast totali i periudhës në të cilën nëpunësi civil punon me vëllim të shtuar nuk mund të kalojë periudhën prej dy (2) viteve të njëpasnjëshme. 5. Shtesa për vëllimin e punës miratohet me lidhjen e marrëveshjes nga zyrtari kryesor administrativ i institucionit me nëpunësin civil për të punuar me vëllim të shtuar, sipas Shtojcës 1, pas konfirmimit nga njësi përkatëse për buxhet dhe financa se nuk është tejkaluar limiti buxhetor, konform njoftimit të përcaktuar në paragrafin 10 të këtij neni. 6. Vlera e shtesës për vëllim të punës është deri në njëzetë përqind (20%) e pagës bazë të nëpunësit civil. 7. Shtesa për vëllimin e punës duhet të ndërpritet në momentin e pushimit të ekzistimit të rrethanave për të cilën është dhënë shtesa. 8. Përderisa nuk përcaktohet ndryshe me ligj, tërësia e shtesave të dhëna sipas këtij neni nuk mund të jetë më e lartë se 0.5% e fondeve totale të përdorura nga organizata buxhetore, për pagën bazë të zyrtarëve publik të organizatës buxhetore në të njëjtin vit fiskal. 9. Për qëllim të zbatimit të këtij neni, Qeveria e Republikës së Kosovës do të trajtohet si një (1) organizatë buxhetore. 10. Ministri përkatës për financa, brenda kufizimeve ligjore, priorizon shpërndarjen e fondeve në dispozicion për shtesën e vëllimit të punës sipas paragrafit 8 dhe 9 të këtij neni tek institucionet dhe i njofton, duke marrë parasysh kriteret si në vijim: 10.1. numrin e të punësuarve në Organizatën Buxhetore dhe mungesat e stafit; dhe 10.2. organizatat buxhetore ku fusha e përgjegjësisë administrative e dy (2) apo më shumë ministrive është bashkuar/fuzionuar në një ministri. 11. Ministria përgjegjëse për financa ka për obligim që të sigurohet se totali i shtesave për vëllim të punës, nuk tejkalon kufirin e përgjithshëm buxhetor të përcaktuar me legjislacionin në fuqi. Andaj Kolegji i Këshillit bazuar në dispozitat e lartshënuara të Rregullores (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik, konstaton se realizimi i shtesës për vëllimin e punës për ankuesen mund të bëhet vetëm pas respektimit të proceduarve sipas kësaj rregullore respektivisht shtesa për vëllimin e punës realizohet vetëm pas miratimit nga zyrtari kryesor administrativ i organit të punësimit gjegjësisht me lidhjen e marrëveshjes nga zyrtari kryesor administrativ i institucionit me ankuesen për të punuar me vëllim të shtuar, dhe meqenëse ankuesja dhe organi i punësimit nuk kanë ofruar dëshmi se ka marrëveshje të lidhur mes zyrtarit kryesor administrativ të institucionit me ankueses për të punuar me vëllim të shtuar, Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor për kompensimin e shtesës është i pa bazuar.

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit të bazës ligjore dhe dëshmive të ofruara konstaton se ankesa e ankuese është pabazuar edhe për faktin se udhëheqësi i drejtpërdrejt i ankueses ka propozuar që të ofrohet mbështetje duke e caktuar një zyrtar që ta mbështesë ankuesen mirëpo kjo e fundit ka kërkuar që mos të caktohet zyrtar por vetëm sipas nevojës kurdo që shtohet volumi i punës, dhe e njëjta asnjëherë nuk ka parashtruar ndonjë kërkesë për të angazhuar ndonjë zyrtarë qoftë ndonjë ore, ditë apo më gjatë si dhe në bazë të përgjigjes se datës 13.09.2023 të dërguar nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Policinë e Kosove dhe shkresave të lëndës ankuesja asnjëherë nuk ka punuar jashtë orarit të rregullt të punës.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1033/2023

Ilire Mehmeti-SHAQIRI

Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit me autorizim avokat [redacted]
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Policinë e Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

15.05.2023
10:50
10.05.2023